



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:234281

Datë: 31.05.2024

Numri i dokumentit: 05760662

C.nr.3619/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Gëzim Shehu, në çështjen juridike kontestimore të paditësve V. S. me numër personal I.B. me numër personal A.R. me numër personal H.N. me numër personal D.H. me numër personal T.C. me numër personal A.B. me numër personal L.G. me numër personal H.S. me numër personal A.S. me numër personal N.M. me numër personal P.T. me numër personal B.R. me numër personal B.B. me numër personal dhe R.O. me numër personal që të gjithë nga Prizreni, të cilët me autorizim i përfaqëson av.A.S. nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit V.I.Xh. me objekt të padisë kompensimi i shujtave, jashtë shqyrtimit kryesor, me datë **31.05.2024**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Pa shqyrtim kryesor të çështjes

- I. **APROVOHET** kërkesëpadia e paditësve V.S., I.B., A.R., H.N., D.H., T.C., A.B., L.G., H.S., A.S., N.M., P.T., B.R., B.B., dhe R.O. që të gjithë nga Prizreni, **në tërësi si e bazuar.**
- II. **DETYROHET** e paditura, Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësve në emër të shujtave ditore, ti paguaj shumat si në vijim:
 - Paditëses V.S. në emër të shujtave ditore, për 206 ditë pune (nga data 27.09.2021, deri me datën 20.11.2022), të paguaj shumën prej nga 2 (dy) euro në ditë, shume prej 412 euro;

- Paditësit I.B. në emër të shujtave ditore, për 206 ditë pune (nga data 27.09.2021, deri me datën 20.11.2022), të paguaj shumën prej nga 2 (dy) euro në ditë, shume prej 412 euro;
- Paditësit A.R. në emër të shujtave ditore, për 206 ditë pune (nga data 27.09.2021, deri me datën 20.11.2022), të paguaj shumën prej nga 2 (dy) euro në ditë, shume prej 412 euro;
- Paditëses H.N. në emër të shujtave ditore, për 206 ditë pune (nga data 27.09.2021, deri me datën 20.11.2022), të paguaj shumën prej nga 2 (dy) euro në ditë, shume prej 412 euro;
- Paditëses D.H. në emër të shujtave ditore, për 206 ditë pune (nga data 27.09.2021, deri me datën 20.11.2022), të paguaj shumën prej nga 2 (dy) euro në ditë, shume prej 412 euro;
- Paditësit T.C. në emër të shujtave ditore, për 206 ditë pune (nga data 27.09.2021, deri me datën 20.11.2022), të paguaj shumën prej nga 2 (dy) euro në ditë, shume prej 412 euro;
- Paditëses A.B. në emër të shujtave ditore, për 193 ditë pune (nga data 08.10.2021, deri me datën 20.11.2022), të paguaj shumën prej nga 2 (dy) euro në ditë, shume prej 386 euro;
- Paditëses L.G. në emër të shujtave ditore, për 259 ditë pune (nga data 27.09.2021, deri me datën 22.11.2022), të paguaj shumën prej nga 2 (dy) euro në ditë, shume prej 518 euro;
- Paditëses H.S. në emër të shujtave ditore, për 208 ditë pune (nga data 19.10.2021, deri me datën 22.11.2022), të paguaj shumën prej nga 2 (dy) euro në ditë, shume prej 416 euro;
- Paditësit A.S. në emër të shujtave ditore, për 209 ditë pune (nga data 27.09.2021, deri me datën 22.11.2022), të paguaj shumën prej nga 2 (dy) euro në ditë, shume prej 418 euro;
- Paditësit N.M. në emër të shujtave ditore, për 209 ditë pune (nga data 27.09.2021, deri me datën 22.11.2022), të paguaj shumën prej nga 2 (dy) euro në ditë, shume prej 418 euro;

- Padiësit P.T. në emër të shujtave ditore, për 209 ditë pune (nga data 27.09.2021, deri me datën 22.11.2022), të paguaj shumën prej nga 2 (dy) euro në ditë, shume prej 418 euro;
- Padiësit B.R. në emër të shujtave ditore, për 209 ditë pune (nga data 27.09.2021, deri me datën 22.11.2022), të paguaj shumën prej nga 2 (dy) euro në ditë, shume prej 418 euro;
- Padiësit B.B. në emër të shujtave ditore, për 209 ditë pune (nga data 27.09.2021, deri me datën 22.11.2022), të paguaj shumën prej nga 2 (dy) euro në ditë, shume prej 418 euro;
- Padiësit R.O. në emër të shujtave ditore, për 209 ditë pune (nga data 27.09.2021, deri me datën 22.11.2022), të paguaj shumën prej nga 2 (dy) euro në ditë, shume prej 418 euro;

-të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, për secilin padiës e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 02.11.2023, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

III. DETYROHET e paditura që padiësve t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej **372 euro**, në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm

A r s y e t i m

Padiësit V.S., I.B., A.R., H.N., D.H., T.C., A.B., L.G., H.S., A.S., N.M., P.T., B.R., B.B., dhe R.O. që të gjithë nga Prizreni, përmes të autorizuarit të tyre av.A.S. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate, me datën 02.11.2023, kanë parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt të padisë kompensimi i shujtave.

I autorizuari i padiësve, në padi kanë theksuar se se padiësit V.S., I.B., A.R., H.N., D.H., T.C., A.B., L.G., H.S., A.S., N.M., P.T., B.R., B.B., dhe R.O. janë në marrëdhënie pune te e paditura, të cilët kanë punuar dhe vazhdojnë të punojnë si mësimdhënës në SHFMU "Naim Frashëri" në fshatin Vlashnje, Komuna e Prizrenit , e që duke llogaritur periudhën kohore të punës, padiësve i takon e drejta e kompensimit të ushqimit në punë për një ditë pune në shumë prej 2 (dy) euro, në bazë të së drejtës që rrjedh nga Kontrata Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 22.01.2021, dhe atë për padiësit V.S., I.B., A.R., H.N., D.H., T.C., A.B., L.G., H.S., A.S., N.M., P.T., B.R., B.B., dhe R.O. Andaj kanë kërkuar që të aprovohet në tërësi kërkesëpadija e padiësve. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura, përmes të autorizuarës së saj, në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve si të pabazuar, lidhur me kompensimin e shujtave ditore. E njëjta ka theksuar se pretendimet e paditësve se iu takon kompensimi i shujtave ditore është në kundërshtim me nenin 2 par.1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, pasi përfitues të beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm antarët e Sindikatës së Arsimit – SBASHK, ndërsa paditësit nuk kanë ofruar ndonjë provë që janë anëtar të sindikatës. Të paditurës nga ana e Ministrisë së Financave nuk i është ndarë kod buxhetor për përmbushjen e obligimeve që dalin nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, andaj e njëjta nuk ka mundësi ligjore për të përmbushur këtë obligim, pasi që bie në kundërshtim me Ligjin për Buxhetin Nr.07/L-001. Gjithashtu e paditura ka theksuar se padia e paditësve është në kundërshtim me nenin 90 par.1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, pasi sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet mes organizatës së punëdhënësit dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë pale nënshkruese e saj. Në fund gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve ta refuzojë në tërësi si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura, përkatësisht mësimdhënës dhe punëmtor teknik pranë SHFMU “Naim Frashëri” në fshatin Vlashnje, Komuna e Prizrenit.

Nga vërtetimi me numër të referencës 128/2023 i datës 30.08. 2023, të lëshuar nga drejtori i shkollës të SHFMU “Naim Frashëri” në fshatin Vlashnje, Komuna e Prizrenit, gjykata vërtetoi faktin se paditësja V.S. është në marrëdhënie punë-mësimdhënëse pranë kësaj shkolle dhe e njëjta për vitin 2021-2022, dhe atë nga data 27.09.2021 e deri me datë 22.11.2022, kanë punuar gjithsej 206 ditë pune.

Nga vërtetimi me numër të referencës 115/2023 i datës 30.08. 2023, të lëshuar nga drejtori i shkollës të SHFMU “Naim Frashëri” në fshatin Vlashnje, Komuna e Prizrenit, gjykata vërtetoi faktin se paditësi I.B. është në marrëdhënie punë-mësimdhënëse pranë kësaj shkolle dhe e njëjta për vitin 2021-2022, dhe atë nga data 27.09.2021 e deri me datë 22.11.2022, kanë punuar gjithsej 206 ditë pune.

Nga vërtetimi me numër të referencës 117/2023 i datës 30.08. 2023, të lëshuar nga drejtori i shkollës të SHFMU “Naim Frashëri” në fshatin Vlashnje, Komuna e Prizrenit, gjykata vërtetoi faktin se paditësja N.B. është në marrëdhënie pune-

mësimdhënëse pranë kësaj shkolle dhe e njëjta për vitin 2021-2022, dhe atë nga data 27.09.2021 e deri me datë 22.11.2022, kanë punuar gjithsej 206 ditë pune.

Nga vërtetimi me numër të referencës 118/2023 i datës 30.08. 2023, të lëshuar nga drejtori i shkollës të SHFMU "Naim Frashëri" në fshatin Vlashnje, Komuna e Prizrenit, gjykata vërtetoi faktin se paditësja D.H. është në marrëdhënie punemësimdhënëse pranë kësaj shkolle dhe e njëjta për vitin 2021-2022, dhe atë nga data 27.09.2021 e deri me datë 22.11.2022, kanë punuar gjithsej 206 ditë pune.

Nga vërtetimi me numër të referencës 123/2023 i datës 30.08. 2023, të lëshuar nga drejtori i shkollës të SHFMU "Naim Frashëri" në fshatin Vlashnje, Komuna e Prizrenit, gjykata vërtetoi faktin se paditësi T.C. është në marrëdhënie punemësimdhënëse pranë kësaj shkolle dhe e njëjta për vitin 2021-2022, dhe atë nga data 27.09.2021 e deri me datë 22.11.2022, kanë punuar gjithsej 206 ditë pune.

Nga vërtetimi me numër të referencës 126/2023 i datës 30.08. 2023, të lëshuar nga drejtori i shkollës të SHFMU "Naim Frashëri" në fshatin Vlashnje, Komuna e Prizrenit, gjykata vërtetoi faktin se paditësja A.B. është në marrëdhënie punemësimdhënëse pranë kësaj shkolle dhe e njëjta për vitin 2021-2022, dhe atë nga data 27.09.2021 e deri me datë 22.11.2022, kanë punuar gjithsej 206 ditë pune.

Nga vërtetimi me numër të referencës 137/2023 i datës 30.08. 2023, të lëshuar nga drejtori i shkollës të SHFMU "Naim Frashëri" në fshatin Vlashnje, Komuna e Prizrenit, gjykata vërtetoi faktin se paditësja L.G. është në marrëdhënie punemësimdhënëse pranë kësaj shkolle dhe e njëjta për vitin 2021-2022, dhe atë nga data 27.09.2021 e deri me datë 22.11.2022, kanë punuar gjithsej 259 ditë pune.

Nga vërtetimi me numër të referencës 129/2023 i datës 30.08. 2023, të lëshuar nga drejtori i shkollës të SHFMU "Naim Frashëri" në fshatin Vlashnje, Komuna e Prizrenit, gjykata vërtetoi faktin se paditësja H.S. është në marrëdhënie punemësimdhënëse pranë kësaj shkolle dhe e njëjta për vitin 2021-2022, dhe atë nga data 27.09.2021 e deri me datë 22.11.2022, kanë punuar gjithsej 208 ditë pune.

Nga vërtetimi me numër të referencës 130/2023 i datës 30.08. 2023, të lëshuar nga drejtori i shkollës të SHFMU "Naim Frashëri" në fshatin Vlashnje, Komuna e Prizrenit, gjykata vërtetoi faktin se paditësi A.S. është në marrëdhënie punemësimdhënëse pranë kësaj shkolle dhe e njëjta për vitin 2021-2022, dhe atë nga data 27.09.2021 e deri me datë 22.11.2022, kanë punuar gjithsej 209 ditë pune.

Nga vërtetimi me numër të referencës 131/2023 i datës 30.08. 2023, të lëshuar nga drejtori i shkollës të SHFMU "Naim Frashëri" në fshatin Vlashnje, Komuna e Prizrenit, gjykata vërtetoi faktin se paditësi N.M. është në marrëdhënie punemësimdhënëse pranë kësaj shkolle dhe e njëjta për vitin 2021-2022, dhe atë nga data 27.09.2021 e deri me datë 22.11.2022, kanë punuar gjithsej 209 ditë pune.

Nga vërtetimi me numër të referencës 132/2023 i datës 30.08. 2023, të lëshuar nga drejtori i shkollës të SHFMU “Naim Frashëri” në fshatin Vlashnje, Komuna e Prizrenit, gjykata vërtetoi faktin se paditësi P.T. është në marrëdhënie punëmësimdhënëse pranë kësaj shkolle dhe e njëjta për vitin 2021-2022, dhe atë nga data 27.09.2021 e deri me datë 22.11.2022, kanë punuar gjithsej 209 ditë pune.

Nga vërtetimi me numër të referencës 134/2023 i datës 30.08. 2023, të lëshuar nga drejtori i shkollës të SHFMU “Naim Frashëri” në fshatin Vlashnje, Komuna e Prizrenit, gjykata vërtetoi faktin se paditësi B.R. është në marrëdhënie punëmësimdhënëse pranë kësaj shkolle dhe e njëjta për vitin 2021-2022, dhe atë nga data 27.09.2021 e deri me datë 22.11.2022, kanë punuar gjithsej 209 ditë pune.

Nga vërtetimi me numër të referencës 135/2023 i datës 30.08. 2023, të lëshuar nga drejtori i shkollës të SHFMU “Naim Frashëri” në fshatin Vlashnje, Komuna e Prizrenit, gjykata vërtetoi faktin se paditësi B.B. është në marrëdhënie punëmësimdhënëse pranë kësaj shkolle dhe e njëjta për vitin 2021-2022, dhe atë nga data 27.09.2021 e deri me datë 22.11.2022, kanë punuar gjithsej 209 ditë pune.

Nga vërtetimi me numër të referencës 136/2023 i datës 30.08. 2023, të lëshuar nga drejtori i shkollës të SHFMU “Naim Frashëri” në fshatin Vlashnje, Komuna e Prizrenit, gjykata vërtetoi faktin se paditësi R.O. është në marrëdhënie punëmësimdhënëse pranë kësaj shkolle dhe e njëjta për vitin 2021-2022, dhe atë nga data 27.09.2021 e deri me datë 22.11.2022, kanë punuar gjithsej 209 ditë pune.

Vërtetimin e lartcekur, Gjykata e pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1, të LPK-së, në të cilin paragraf përcaktohet se “*Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të*”. Andaj pasi këto vërtetime janë lëshuar nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj, e të cilat si të tilla janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, ashtu që vërtetimeve të SHFMU “Naim Frashëri” në fshatin Vlashnje, Komuna e Prizrenit, gjykata i’a fali besimin e plotë, si provë me të cilën vërtetohet fakti lidhur me ditët e punës, konkretisht paditësit V.S., I.B., H.N., D.H., T.C., A.B., L.G., H.S., A.S., N.M., P.T., B.R., B.B., dhe R.O., nga data 01.01.2022, deri me datën 22.11.2022, kanë punuar të gjithë në shkollën e lartpërmendur, me ditët e pranisë në punë, të specifikuara si më lartë.

Bazuar në faktet e çështjes, Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, me nr.01/B, nr. prot. 105, e datës 22.01.2021, të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021.

Me nenin 35 par.7, të Kontratës Kolektive të Arsimit, nr.01/B, nr. prot. 105, e datës 22.01.2021, është përcaktuar e drejta e punëtorëve në kompensimin e shujtave dhe atë *“Të punësuarve (antarë të SBASHK-ut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy euro për të punësuarit të cilët kanë marrëdhënie pune primare në institucionet arsimore...”*. Në rastin konkret gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditësve si punëtorë të arsimit, t’ia paguaj kompensimin për shujtat ditore, konform detyrimeve që rrjedhin nga Kontratata Kolektive, e në kuptim të Nenit 55 par.1 dhe 2 të Ligjit të Punës. Rrjedhimisht lidhur me kompensimin e shujtave ditore për paditësit V.S., I.B., H.N., D.H., T.C., A.B., L.G., H.S., A.S., N.M., P.T., B.R., B.B., dhe R.O., për secilin nga ta kërkesa është bërë e arritshme, përkatësisht për periudhën nga data 01.01.2022 e deri me datë 22.11.2022.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 152 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: *“Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij.”*

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (31.10.2023), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Andaj, bazuar në dispozitat e nenit 152 të LPK-së, Gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë pa caktuar seancë gjyqësore, pasi që vlerësoi se në rastin konkret, kërkesëpadia e paditëses është qartazi e themeltë pasi që bazohet në dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, ndërsa shuma e kompensimit vërtetohen nga provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigj në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit merititor. Andaj, mbi këtë bazë gjykata aprovoi kërkesëpadinë e paditësve sikurse në dispozitiv të aktgjykimit.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 312.00 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 60.00 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej dyqindetëdhjetë euro (372.00€).

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 152 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL
C.nr.3619/2023, datë 31.05.2024

G j y q t a r i

Gëzim Shehu

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimet pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.